



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Nr. 4634/1 Prot. Datë 22.07.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT

Nr. 9438/2 Prot. Datë 22.7.2024

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 15, datë 22.07.2024

PËR
ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E SESIONIT TË DYTË TË PROVIMEVE TË
MATURËS SHTETËRORE 2024 DHE MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2024

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 26 dhe nenit 51 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJMË:

- Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2024, sesioni i dytë, të jenë:

a) Gjuhë e huaj	16 gusht 2024
b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi	22 gusht 2024
c) Matematikë	28 gusht 2024
ç) Provimi me zgjedhje	04 shtator 2024
- Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2024, sesioni i dytë, të jenë:

a) Gjuhë e huaj	16 gusht 2024
b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi	22 gusht 2024
c) Matematikë	28 gusht 2024
ç) Provimi i teorisë profesionale të integruar	04 shtator 2024
- Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2024 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2024, sesioni dytë, bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore.
- Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2024 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2024, sesioni i dytë:

- a) Fillojnë në orën 10:00;
 - b) Zgjasin 2 orë e 30 minuta;
 - c) Testet hartohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).
5. Në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2024 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2024, sesioni i dytë, marrin pjesë:
- a) Maturantët që rezultojnë mbetës në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore 2024 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2024, sesioni i parë.
 - b) Maturantët që rezultojnë mbetës në një ose dy lëndë në vitin shkollor 2023-2024 dhe i shlyejnë provimet shkollore brenda datës 06 gusht 2024.
 - c) Maturantët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë para vitit 2024, por që nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale në vitin 2024, sesioni i parë.
 - ç) Maturantët/kandidatët që kanë kryer njohjen dhe njësimin e diplomës së arsimit të mesëm të lartë dhe kanë detyrime të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2024.
6. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja “c” dhe “ç”, të këtij udhëzimi të regjistrohesh në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë ose në shkollën që u cakton zyra vendore e arsimit parauniversitar (ZVAP).
7. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja “b”, “c” dhe “ç”, të këtij udhëzimi, të plotësojnë Formularin AIZ, për dhënien e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2024, nëse nuk e kanë plotësuar atë në sesionin e parë.
8. Maturantët/kandidatët me aftësi të kufizuara do të zhvillojnë provimet e Maturës Shtetërore bazuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 49 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
9. Bazuar në memorandumin e bashkëpunimit/mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit të Republikës së Italisë, për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane, provimi “Gjuhë dhe letërsi italiane”:
- a) Përgatitet nga Ministria e Arsimit të Republikës së Italisë dhe dorëzohet në QSHA;
 - b) Zhvillohet me gojë, në shkollë në datën 15.08.2024;
 - c) Zhvillohet me shkrim në mjedisin e provimit të Maturës Shtetërore, në datën 16.08.2024;
 - ç) Rezultati i provimit gjuhë e huaj (D3), llogaritet sipas përcaktimeve të memorandumit të bashkëpunimit/mirëkuptimit, të përmendur në këtë pikë.
10. Drejtori i institucionit arsimor parauniversitar dërgon zyrtarisht në ZVAP, listën e maturantëve që do të marrin pjesë në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2024 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2024, sesioni i dytë, deri më datë 07 gusht 2024. Drejtori i ZVAP, ta dërgojë këtë listë në QSHA, në datën 08 gusht 2024.
11. Provimet të zhvillohen të përqendruara. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) përcakton qendrat e provimeve duke u bazuar në numrin e maturantëve dhe në largësinë nga qendra e provimit.
12. ZVAP-et dhe drejtoritë e institucioneve arsimore parauniversitare, të marrin masa për njoftimin e maturantëve për qendrën, datat dhe orën kur do të zhvillohet secili nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2024 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore

Profesionale 2024, sesioni i dytë.

13. Drejtori i AKAP, brenda datës 9 gusht 2024 të njoftojë zyrtarisht QSHA-në dhe MAS, për qendrat dhe mjediset ku do të zhvillohen provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2024, sesioni i dytë dhe për listën e shkollave që marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2024 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2024, sesioni i dytë.
14. Monitorimi i procesit të Maturës Shtetërore 2024 dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MAS-it dhe të institucioneve të varësisë.
15. Shpenzimet e përfaqësuesve të MAS-it për monitorimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2024 dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024, sesioni i dytë, të mbulohen nga institucionet ku janë të punësuar.
16. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTËR

OGERTA MANASTIRLIU



MINISTËR

BLENDI GONXHJA

